

AKT THEMELIMI

I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

"BOSS CONSTRUCTION" SHPK

Sot më datë, 09.01.2018 ne shtetasit:

- I. Saimir Peci , i datëlindjes 04.02.1968, i lindur në Lushnje, e banues në Tiranë në adresën Rruga Asim Vokshi,Nd14,N25,Ap21,Kodi Postar 1016,Njesia Bashkiake Nr.9,mbajtës i kartes se identitetit nr 032026124, me nr personal G80204047J me date skadence 16-12-2022 me cilesinë e "ortakut te vetem themelues" ; kam redaktuar këtë akt themelimi, nëpërmjet të cilit deklarojmë se me vullnet të lire të plote,dhe inisiativen e lirë private, mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë në Kodin Civil në fuqi, në ligjin 9901 date 14.04.2008, " Për shoqërite tregtare ", në ligjin " Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", në atë Doganor, Fiskal e Tatimor, vendosëm të krijojmë shoqërinë tregtare, me pergjegjësi të kufizuar, "**SHPK**."

Neni 1

Krijimi

Shoqëria "**BOSS CONSTRUCTION" SHPK**

është person juridik i të drejtës shqiptare, Shoqëri me përgjegjesi të kufizuar dhe regjistrohet si biznes i vogel me tvsh(këtu e më poshtë e quajtur "Shoqëria").

Neni 2

Personaliteti juridik

Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

Shoqëria "**BOSS CONSTRUCTION" SHPK**,është një e tillë, kapitali i së cilës ndahet në kuota dhe që themelohet nga ortaku që përballon humbje vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tij në kapitalin themeltar.

Neni 3

Selia

Shoqëria e ka selinë në Adresën:

Njesia Bashkiake nr.9 Sheshi Hari Trumen nr.3,Hyrja 15 Ap 2.

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, degë, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim te Asamblesë së Ortakëve.

Neni 4

Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Saimir Peci
Saimir Peci

Neni 5
Objekti i veprimtarisë

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm :

Te operoje ne sektorin e ndertimit,elektrik,hidraulik,transportit per vete dhe per te tretet,materiale hidrosanitare, prodhime te ndryshme betoni armatura te ndryshme,ne sektorin enegjistik,arkitekturor,rikonstruksione,asistence ne punime te ndryshme si dhe ushtrimi i cdo lloj aktiviteti tjeter qe do kerkohet nga klientela e tregut, duke respektuar ligjin ne fuqi.

Punime te inxhinierise se mjedisit,punime per prishjen e ndertimeve,impiante hidrosanitare,kuzhina,lavanteri,mirmbajtja e tyre,impiante ngritese dhe transportuese(ashensore,shkalle levizese,transportues).Punime rifinitura te muratures dhe te lidhura me to,rifiniture me materiale druri,plastik,metalik,dhe xhami dhe rifiniture te natyres teknike ndertuese. Punime topogjeodezike,sistemet kunder zhurmes per infrastrukture. Shpime gjeologe-inxhinierike,puse dhe shpime per uje. Prodhim material ndertimi dhe tregtim i materialeve te ndertimit.

Mirmbajtje te ndryshme te realizuara prej saj dhe per te trete,import-eksport i materialeve te ndryshme te ndertimit qe kane lidhje me objektin e veprimtarise.Shoqeria ka te drejte te ushtroje cfaredo lloj veprimtarie tjeter te lejuar nga ligji dhe ne perputhje me rregullat ne fuqi.

Neni 6
Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 lekë dhe është i ndarë në 1 kuota ,

vlera nominale e të cilave është:

(1) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100.000 Lekë.

(2) Ky kapital perfaqeson 1 kuotë , me vlere nominale :

- Saimir Peci, 1 kuotë me vlerë nominale 100.000 (njëqind) mijë lekë) lekë; të zotëruara dhe të kontribuara nga ortakët e shoqërisë si më sipër,kuota këto me vlerë të përgjithshme 100.000 lekë të cilat përbëjnë 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme dhe as me kontribute në shërbime.

Ortakët pergjigjet per humbjet e shoqërisë përkundrejt të tretëve deri në vlerën e kontributit të tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Neni 8
Organi Vendimmarrës

Asambleja e ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e ortakëve brenda një afati prej gjashtë muajsh, duke filluar nga data e mbylljes së vitit financiar, miraton raportin e administrimit, inventarin, bilancin dhe llogaritë vjetore, të

Saimir Peci
Saimir Peci

hartuara nga administratorët, Ai mund të përfaqësohet edhe nga një tjetër person, nëpërmjet prokurës.

Administratorët – Organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

Neni 9
Ndryshimet e Statutit

Ndryshimet e statutit vendosen nga Asambleja e ortakëve.
Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR –së për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

Neni 10
Administrimi

Administratorët emërohet dhe shkarkohet me vendim të Asamblesë së ortakëve të shoqërisë. Asambleja e ortakëve vendos për sistemin e administrimit, dhe në rastin e një organi administrativ me shumë administratorë, përcakton numrin e tyre dhe kompetencat.

Administratori/rët, mund të jenë ose jo ortakë.

Administratori mund të shkarkohet në çdo kohë.

Administrator i shoqërisë është për një periudhe 5 vjeçare sipas ligjit.

Neni 11

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë akt themelimi, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për shoqëritë tregtare".

Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë që ka lidhje me objektin e veprimtarisë së shoqërisë.

Neni 12
Dispozita perfundimtare

Ky akt themelimi pasi u redaktua dhe lexua nga ortakët themelues, miratohet në parim dhe nen për nen nga ortakët themelues të shoqërisë tregtare, dhe nënshkruhet prej tyre

ORTAKU I VETËM THEMELUES
SAIMIR PEÇI



DT. 09.01.2018